



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TË FILOZOFISË**

**SHKURT 2024**  
**Koordinatore**  
**Astrit Dautaj**

## 1) HYRJE

Programi i zhvillimit profesional, për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të **filozofisë** është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së filozofisë në përgatitjen për testimin kombëtar, për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të lëndës së filozofisë në veçanti;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës së filozofisë sipas programeve lëndore përkatëse.

## 1) QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së filozofisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të

---

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

mësuesve. Në këtë aspekt, programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;

- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### **Programi synon që mësuesi:**

- të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të rrisë përgjegjshmërinë për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të rrisë aftësitë dhe kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme;
- të rrisë përgjegjshmërinë për njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të rrisë përgjegjshmërinë për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të rrisë aftësitë në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- të realizojë në praktikë, nëpërmjet demonstrimit konkret, aftësitë e fituara e në mënyrë të veçantë, nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### **Objektivat afatshkurtër të programit**

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor dhe veçanërisht risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat bazuar në standardet profesionale të mësuesit për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;

- të zotërojë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të mundësojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të reja të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe veçoritë e klasave ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

## **2) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të filozofisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së filozofisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit dhe literaturën përkatëse rekomanduese për këtë qëllim.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe standardet e mësuesit të lëndës së filozofisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

### Fusha: Dokumentet zyrtare

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë;</li><li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li><li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li><li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li><li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li><li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li><li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li><li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li><li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li><li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022).</li><li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021</li><li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li><li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li><li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për</li></ul>

	<p>vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
--	---

**Fusha: Programet lëndore**

<b>Rezultati</b>	<b>Literatura</b>
<b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë për nxënësit;</li> <li>• të analizojë karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës;</li> <li>• të vlerësojë zbatimin cilësor të programit: kërkesat ndaj mësuesit si zbatues i programit lëndor;</li> <li>• të vërë në dukje të rishikimi i programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose përmirësimit të programit lëndor;</li> <li>• të dallojë strukturën e programit lëndor dhe të përshkruajë përmbajtjen e rubrikave të saj;</li> <li>• të përshkruajë lidhjet ndërmjet njohurive të lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza Kurrikulare, 2014.</li> <li>• Programi i lëndës “Filozofia” për gjimnazin, për arsimin profesional dhe për arsimin e orientuar (social – kulturor).</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X-XII.</li> </ul>

**Fusha: Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie**

<b>Rezultati</b>	<b>Literatura</b>
------------------	-------------------

Mësuesi do të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep;</li> <li>• të zhvillojë koncepte dhe metoda që e bëjnë nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja;</li> <li>• të jetë i hapur për bashkëpunim dhe vlerësim të punës që bën;</li> <li>• të dallojë pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar;</li> <li>• të hartojë objektiva të nxënit;</li> <li>• të dallojë dhe të hartojë objektiva arritjeje në nivele të ndryshme;</li> <li>• të zbatojë njohuritë e tij për krijimin e një klime të përshtatshme të mësuarit në klasë;</li> <li>• të dallojë dhe të përzgjedhë metoda dhe teknika të përshtatshme me objektivat e të mësuarit dhe stilet e ndryshme të të mësuarit;</li> <li>• të strukturojë një ditar dhe të tregojë qëllimin e rubrikave të tij;</li> <li>• të përcaktojë synimet ose objektivat e kurrikulës në përputhje me filozofinë arsimore të përzgjedhur;</li> <li>• të alternojë metodat e punës individuale dhe asaj në grup në varësi të objektivave të të mësuarit;</li> <li>• të zbatojë teknika dhe forma të ndryshme të vlerësimit të nxënit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018.</li> <li>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.</li> <li>• Materiale ndihmëse për edukimin qytetar <a href="https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/">https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/</a> Demokracia në veprim <a href="https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/">https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/</a> .</li> </ul> <p>Vëllimi 1</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit (faqe 60-64).</li> <li>- Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve (faqe 65-72).</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtimi i procesit të të nxënit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies faqe 81-82, 87-88, 90-92.</li> <li>• Manuali për edukimin e qytetarisë digjitale i Këshillit të Evropës.</li> </ul> <p>Materiale ndihmëse për edukimin qytetar  <a href="https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/">https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/</a>  faqe 11-15.</p>
--	--

**Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit**

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë parimet themelore mbi të cilat është hartuar kodi i etikës së mësuesit;</li> <li>• të dallojë sjelljet e mësuesit që burojnë nga parimet themelore;</li> <li>• të hartojë vetë një kod të thjeshtë sjelljeje që bazohet në parimet dhe standardet e kodit të etikës;</li> <li>• të përshkruajë sjelljet model që duhet të karakterizojnë zbatuesit e kodit të etikës së mësuesit, në varësi të funksionit që ka në komunitetin e shkollës;</li> <li>• të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>

**Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe**



<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të zbatojë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe standarde.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>
<b>Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës</b>	
<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të ndihmojë nxënësit të përdorin koncepte kyçe si koha, hapësira, shkakësia, ndërgjegjja, e pandërgjegjshmja, gjuha, racionalja, irracionalja, gjykimi, e vërteta, liria, vdekja, personi, e drejta, shteti, antropologjia, nihilizmi, morali, feja, arti, puna, ekzistenca, logjika dhe matematika, të kuptuarit, teoria, përvoja, shkenca, puna, ndryshimi, konflikti dhe ndërlikimi për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis modeleve të ndryshme historike dhe vazhdueshmërisë;</li> <li>të ndihmojë nxënësit të analizojnë pikëpamjet e filozofëve të ndryshëm, pjesë të programit të filozofisë, për këto koncepte dhe të shprehin qëndrimet e veta ndaj tyre;</li> <li>t'u japë mundësi nxënësve të njohin dhe përshkruajnë periudhat historike të filozofisë, të analizojnë mendime të filozofëve të ndryshëm në këto periudha duke përfshirë zhvillimin e</li> </ul>	<p>Tekste për nxënësin për lëndën e filozofisë, literaturë shkencore dhe burimore për përmbajtjen e lëndës.</p>

kulturave dhe qytetërimeve që nga antikiteti deri në ditët tona;

- të drejtojë nxënësit në përdorimin e proceseve të tilla si te kërkimi historik kritik për të rindërtuar dhe interpretuar të kaluarën, si p.sh., të përdorin burime të ndryshme dhe të kontrollojnë vërtetësinë e tyre, t'i vlerësojnë këto procese, të kërkojnë për rastësinë dhe të bëjnë dallimin midis ngjarjeve dhe zhvillimeve që janë domethënëse dhe atyre që janë të palogjikshme;
- të mbështesë nxënësit në kuptimin dhe përdorimin e koncepteve, teorive dhe parimeve lidhur me njohjen njerëzore, zhvillimin shoqëror dhe personal si dhe me rritjen e ndryshimin;
- t'i bëjë nxënësit të marrin parasysh se si faktorë të tillë si memoria, të menduarit, besimet, emocionet, personaliteti, perceptimet, sjellja dhe aftësitë ndikojnë në veprimet dhe vendimet e njerëzve në momente të caktuara.

### 3.1.1 Model testi

#### DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Bazuar në Udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim për parregullsitë gjatë zhvillimit të provimit ose për ndëshkimet që i janë dhënë nga administratori: **1 pikë**
  - A) brenda 2 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - B) brenda 3 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - C) brenda 4 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - D) brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  
2. Vetëvlerësimi dhe analiza serioze, e detajuar dhe periodike e vetes mbi bazën e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm i jep mësuesit një mundësi të çmuar për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta. Nivelet e arritjeve përmes të cilave mësuesit mund të bëjnë vetëvlerësimin dhe të përcaktojnë arritjen e kompetencës së tyre profesionale janë: **1 pikë**
  - A) dy.
  - B) tre.
  - C) katër.
  - D) pesë.
  
3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G). **2 pikë**
  - a) Komisioni i disiplinës në shkollë ngrihet në çdo fillim të vitit shkollor dhe kryesohet nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_
  - b) Komisioni i disiplinës në shkollë i merr vendimet me votim të hapur. V/G \_\_\_\_\_

## PROGRAMI LËNDOR

4. Kurrikula në bazë shkolle synon kryesisht:

**1 pikë**

- A. të unifikojë arsimin në nivel kombëtar
- B. të vendosë kritere për të matur arritjet e nxënësve në nivel vendor
- C. t'u ofrojë nxënësve mundësinë për të përfituar përvoja të reja arsimore
- D. të pajisë nxënësit me aftësitë e nevojshme për punësim në nivel vendor

5. Zgjidhni e vërtetë (V) apo e Gabuar (G) në lidhje me pohimin e mëposhtëm **1 pikë**  
Kurrikula e lëndëve shoqërore synon të sigurojë dhe të forcojë tek nxënësit bindjen ndaj politikave të shtetit demokratik \_\_\_\_\_

6. Rezultati i pritshëm i të mësuarit “Nxënësi përshkruan marrëdhëniet ndërmjet edukimit për median dhe informimin, qytetarisë dhe demokracisë” lidhet me njërin prej kompetencave të mëposhtme.

Rezultati i pritshëm i mësipërm, lidhet më shumë me:

**1 pikë**

- A. Të kuptuarit e rolit të medias dhe të informacionit në demokraci
- B. Të kuptuarit e përmbajtjes së medias dhe të përdorimit të saj
- C. Sigurimin me cilësi dhe rendiment të informacionit
- D. Vlerësimi kritik i informacionit dhe i burimeve të tij

7. Plotësoni vendet bosh me fjalën ose togfjalëshin e duhur

Për të hartuar kurrikulën në bazë shkolle mësuesi duhet të dijë:

**3 pikë**

A. kërkesat që ushtron ndaj ..... mjedisi vendor	A. arritjet e nxënësve
B. .... dhe	B. shkollës

prejardhjen e nxënëse	
C. .... në nivel vëndor	C. njohuritë

## ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

8. Lidhur me kompetencën e mësuesit për të zotëruar përmbajtjen e materialit mësimor, ka më shumë nevojë për trajnim mësuesi që: **1 pikë**

- A. mbështetet tek teksti mësimor dhe udhëzuesi i mësuesit për të zhvilluar mësimin
- B. është në dijeni të zhvillimeve dhe të materialeve të reja që lidhen me lëndën
- C. paraqet gjithnjë informacion të besueshëm dhe që lidhet me lëndën dhe me temën konkrete që trajton
- D. asnjë nga të mësipërmet

9. Ju, si mësues keni vendosur të përdorni **median** në një orë mësimore për të rritur vetëdijen e nxënësve tuaj, jo vetëm për mundësitë që ofron media në fushën e edukimit, por edhe për rreziqet që bart. Shkruani 3 objektiva të mësuarit (pritshmëri në tre nivele arritjeje) që ju synoni të arrini përmes një orë mësimore **3 pikë**  
Në fund të orës mësimore, pritet që nxënësit të jenë të aftë:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

10. Për të shmangur konfliktet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve në fushën e vlerësimit mësuesi duhet: **1 pikë**

- A. Të bindë nxënësit në drejtësinë e vendimit të tij
- B. Të mos lejojë diskutime me nxënësit për notën e vënë

- C. Të bëjë të qarta që në fillim kriteret e vlerësimit të nxënësve
- D. Të rishikojë vendimin e tij

**11.** Përshkruani fillimisht, çfarë duhet jetë i aftë të bëjë një nxënës në një temë të caktuar mësimore dhe pastaj përcaktoni rezultatet e pritshme të të mësuarit në tre nivelet e arritjeve sipas skemës së mëposhtme: **4 pikë**

Rezultati i pritshëm i të nxënësit sipas temës mësimore ose kurrikulës së lëndës:

“Nxënësit, në fund të orës së mësimit, duhet të jenë të aftë të .....

.....

Rezultatet e pritshme të të mësuarit në tre nivele

Në fund të orës së mësimit, pas përpjekjeve të përbashkëta, nxënësit do të jenë të aftë:

Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli i lartë
Të ....	Të .....	Të .....

**12.** Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G).

Për të parandaluar ose për të pakësuar në mënyrë të efektshme paragjykimet në klasën e tyre, mësuesit: **4 pikë**

- a. Duhet të jenë model i sjelljeve dhe qëndrimeve pa paragjykimet \_\_\_\_\_
- b. Duhet t’i kushtojnë për një kohë të caktuar trajtimit të çështjeve të pakicave \_\_\_\_\_
- c. Duhet të dënojnë fëmijët që shfaqin paragjykimet \_\_\_\_\_
- d. Duhet të shpërfillin si të parëndësishme shprehjet e paragjykimëve dhe të njëanshmërive në klasë. \_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

- 13.** Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi: **1 pikë**
- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
  - B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
  - C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
  - D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.
- 14.** Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për treguesit e parimit të përkushtimit ndaj komunitetit të përcaktuara në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**
- a. Në zbatim të parimeve të kodit të etikës, mënyra më e mirë për të vlerësuar qëndrimet e nxënësve në shkollë do të ishte mosvlerësimi i qëndrimeve vetjake.  
\_\_\_\_\_
  - b. Sipas Kodit të Etikës, mësuesi i përkushtohet vetëm nxënësve me aftësi të kufizuar duke ushqyer potencialin qytetar, shoqëror, intelektual , emocional dhe fizik të tyre  
\_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

- 15.** Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**
- A) Këshilli Kombëtar i Prindërve
  - B) këshilli kombëtar i prindërve
  - C) Këshilli kombëtar i prindërve
  - D) Këshilli Kombëtar i prindërve
- 16.** Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme. **3 pikë**

- a) Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qendrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin e lartë ose për tregun e punës.
- b) Nxënësi deri në moshën njëzetë e dy vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar.
- c) Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument ku shënohet synimi i veprimtarisë dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.

## **PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

**17.** Koncepti i mitit përcaktohet si:

**1 pikë**

- A) përpjekje për të shpjeguar fenomenet mbi shkaqe natyrore.
- B) formë e besimit tek të vërtetat shkencore mbi natyrën.
- C) shpjegim i gjithçkaje sipas një rregullsie objektive.
- D) drejtim i botës nga veprimi i forcave hyjnore.

**18.** Ideja se lufta mes të kundërtave është burim zhvillimi, i përket filozofit të lashtësisë:

**1 pikë**

- A) Leucipi.
- B) Herakliti.
- C) Thalesi.
- D) Aristoteli.

**19.** Skeptikët lidhur me njohjen njerëzore, theksojnë:

**1 pikë**

- A) njohjen e pasigurtë të shqisave njerëzore.
- B) informacionin e saktë përmes ndijimeve.
- C) kontrollin e arsyes nga organet e shqisave.



D) përvojën e njëjtë të shqisave në kushte të ndryshme

**20.** Dialektika sokratike bazohet në:

**1 pikë**

- A) pranimin e çdo opinioni të dhënë.
- B) bindjen ndaj autoritetit të dijes.
- C) dialogun mes të kundërtave.
- D) të vërtetat e gjithëpranuara.

**21.** Rilindja Europiane dallohet nga Mesjeta, sepse:

**1 pikë**

- A) kultura dhe filozofia bazohen në fuqinë njerëzore.
- B) shkenca është e mbështetur në dogmat fetare.
- C) arti dhe kultura janë në shërbim të fesë.
- D) universi konceptohet i kufizuar.

**22.** Në shekullin XIV, raporti arsye-besim u zhvillua në drejtim të: **1 pikë**

- A) kufizimeve të arsyes.
- B) forcimit të rolit të arsyes.
- C) nënshtrimit të filozofisë nga feja.
- D) ndarjes së filozofisë nga feja.

**23.** Në teorinë e tij të njohjes, Dekarti pranon se:

**1 pikë**

- A) Njohja realizohet përmes eksperiencës.
- B) Idetë në mendjen e njeriut janë të lindura.
- C) Përvoja e njeriut përftohet nga shqisat.
- D) Idetë kufizohen nga përvoja e subjektit.

**24.** Gjendja natyrore” e përshkruar nga Hobsi njih:

**1 pikë**

- A) luftën e të gjithëve kundër të gjithëve;
- B) harmoninë e përkryer midis njerëzve;
- C) jetën e lumtur të njerëzve;
- D) rëndësinë që ka metafizika.

- 25.** Parimi i “dobisë” qëndron në themel të filozofisë: **1 pikë**
- A) utilitariste.
  - B) iluministe.
  - C) materialiste.
  - D) Idealiste
- 26.** Thelbi i njohjes, sipas filozofisë së Xhon Djuj, është: **1 pikë**
- A) përvoja.
  - B) intuita.
  - C) arsyeja.
  - D) dyshimi.
- 27.** Në një tekst filozofie ndodhet skica e një filozofi me diçiturën: “Filozofi në kërkim të një padroni”.
- 1 pikë**
- Interpretimi më i pranueshëm i kësaj diçiture është që ky filozof:
- A) është i gatshëm të heqë dorë nga pikëpamjet e tij për...
  - B) po pohon që është padron i vetvetes
  - C) kërkon padronët të cilët kanë nevojë për pikëpamjet e tij
  - D) filozofi nuk interesohet për pasojat e pikëpamjes së tij.
- 28.** Teoria marksiste mbështet: **1 pikë**
- A) transformimin e superstrukturës.
  - B) përsosjen e shoqërisë kapitaliste.
  - C) përmbysjen e kapitalizmit me dhunë.
  - D) ndryshimin vetëm të institucioneve drejtuese.
- 29.** Xhon Loku thekson rëndësinë e konkurrencës ndërmjet interesave të ndryshme në një shoqëri pluraliste, ku të gjithë bien dakord për vendime që i shërbejnë të mirës së përbashkët. Identifikoni tre tipare të demokracisë shqiptare në këndvështrimin e Xhon

Lok, duke u përqendruar në faktorët që i kundërvihen të mirës së përbashkët:

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**30.** Sipas parimeve stoike, tri rrugët që çojnë drejt lumturisë dhe paqes së shpirtit janë:

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**31.** Shpjegoni si e argumenton Shën Agustin, thënien e tij se “Zoti nuk është shkaku i të keqes në botë”:

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**32.** Tregoni tri tipare të filozofisë iluministe të shekullit të XVIII

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**33.** Përshkruani tri aspekte të kuptimit të Niçes për mbinjëriun

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**34.** Përshkruani tri elemente të pikëpamjet së Hegelit për shtetin dhe vendin ose raportin e qytetarëve me të

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_

- b) \_\_\_\_\_  
c) \_\_\_\_\_

**35.** Dy ndër karakteristikat e epokës së Mesjetës në Evropë janë: **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
b) \_\_\_\_\_

**36.** Përshkruani dy karakteristika historike dhe sociale të shekullit të 19 dhe 20, që përcaktuan sistemet e mëdha filozofike të kohës: **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
b) \_\_\_\_\_

#### **E Vërtetë (V) apo e Gabuar (G)**

**37.** Iluministët frymëzuan liritë e njeriut dhe emancipimin e shoqërisë. \_\_\_\_ **1 pikë**

**38.** Sipas Monteskjës, pushteti duhet të jetë të jetë i shkrirë në një dorë të vetme. \_\_\_\_  
**1 pikë**

**39.** Loku arsyetonte se Zoti ishte fakt, sepse mund të provohej empirikisht. \_\_\_\_ **1 pikë**

**40.** Volter e quante fanatizmin sëmundje për mendjet njerëzore. \_\_\_\_ **1 pikë**

**41.** Sipas Kantit, pjesa e sendit, të cilën e kemi të pamundur ta njohim, quhet “send në vetvete”. \_\_\_\_ **1 pikë**

**42.** Hegeli brenda triadës së filozofisë së tij nuk e pranon ndryshimin. \_\_\_\_  
**1 pikë**

### ***3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshatën me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

#### ***3.2.1 Modele orësh mësimore për lëndë shoqërore***

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*



## Veprimtari 1

**Tema: Ndal është jeta ime.**

### Qëllimi

Kjo veprimtari mund të zhvillohet në kuadrin e një ore që mund të ketë si objektiv trajtimin e ndryshimeve kulturore dhe subkulturore të njerëzve dhe rëndësisë së njohjes, të vlerësimit dhe të respektimit të tyre për përmirësimin e cilësisë së marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në veçanti. Po kështu, kjo veprimtari krijon mundësi për trajtimin e rëndësisë që ka njohja e veçorive të secilit për parandalimin ose zgjidhjen e konflikteve.

Përveç kësaj kjo veprimtari është edhe një shembull i përdorimit të llojeve të ndryshme të objektivave në fushën e edukimit të të drejtave të njeriut të trajtuar më sipër.

Kjo veprimtari synon:

- ☞ të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e njohjes së karakteristikave të tjetrit:
  - për krijimin e harmonisë në marrëdhëniet shoqërore,
  - për parandalimin e konflikteve që lidhen me mosrespektimin e veçorive të secilit,
  - për të ndihmuar të tjerët në raste fatkeqësish, traumash, apo vështirësish të natyrave të ndryshme,
- ☞ të aftësojë nxënësit të marrin parasysh veçoritë individuale dhe ato të jetës private në komunikimin e tyre të përditshëm në shoqëri.

### Rezultatet e pritshme të të mësuarit:

Në fund të këtij aktivitetit nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë mes të drejtave të shumta , të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (*njohja*),
- të lidhë standardin me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit(*kontekstualizimi*),
- të tregojë, përmes vendimmarrjes, rëndësinë e respektimit të jetës private të tij dhe të të tjerëve, duke marrë parasysh kulturën, zakonet, traditat etj. (zbatimi)

**Koha: 45'**

### Zhvillimi i veprimtarisë

### Hapi i parë

Mësuesi u jep nxënësve situatën e mëposhtme:

Mendoni veten në rolin e një gazetari që cili kërkon të intervistojë tri personazhe femra për jetën e tyre private. Personazhet ndodhen:

- Në Shqipëri
- Në SHBA
- Në Filipine

Mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë tri pyetje që do ua drejtojnë personazheve në fjalë. Pasi secili nxënës shkruan pyetjet në një letër, ata e kthejnë letrën përmbys.

### Hapi i dytë

Në këtë fazë mësuesi kërkon nga nxënësit të mendojnë në mënyrë individuale dhe më pas të radhitin në një fletë të bardhë:

- 3 gjëra që *lehtësisht* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra që me *vështirësi* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra të cilat nuk do të dëshironin t'i bisedonin me të tjerët, duke iu quajtur vatëate.

### Hapi i tretë

Pas kësaj klasa ndahet në grupe dhe secilit grup i kërkohet të diskutojë e të marrë vendim për të bërë ndarjen e mësipërme.

Pasi nxënësit të kenë realizuar detyrën, mësuesi ndërton, në tabelë ose në një tabak të madh letre kolonat e mëposhtme:

Të thjeshta për t'i diskutuar me të tjerët	Të vështira për t'i diskutuar me të tjerët	Private

Më pas ai dëgjon raportimet e grupeve dhe bën plotësimet sipas kolonës.

### Hapi i katërt

Mësuesi dialogon me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjet e mëposhtme:

- *Përse disa gjëra diskutohen lehtë me të tjerët e të tjera jo?*
- *Cilat janë të përbashkëtat për secilën kategori në ndarjet tuaja?*
- *Si e shpjegoni faktin që të njëjtat gjëra i shohim në tituj të ndryshëm (një vajzë i tregon nënës, një tjetër jo)?*
- *A mund të ketë një ndarje fikse në qëndrimet e njerëzve për të njëjtat gjëra? Pse ekzistojnë konceptime të ndryshme për gjërat private? Cilët janë faktorët që ndikojnë në të?*



- *A ndikon kjo edhe në mënyrën se si njerëz të ndryshëm përjetojnë situata të njëjta ose të ngjashme?*

Gjatë diskutimit mësuesi e përqendron vëmendjen e nxënësve te rëndësia që ka respektimi i individualitetit të secilit kur bëhet fjalë për çështje që prekin ndjenjat, hapësirat e jetës private të njerëzve të cilat siç e pamë lidhen ngushtë me prejardhjen e tij psiko-kulturore, familjare, me statusin e tij social etj.

## **Hapi i pestë**

*Reflektim.*

Në këtë fazë, mësuesi fton nxënësit një proces reflektimi duke zhvilluar pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë të drejtat e njeriut që përfshihen në këtë rast studimor?
- Si e kuptoni ju të drejtën për një jetë private?
- Nga varet realizimi i të drejtës për një jetë private? Çfarë e rrezikon atë?
- Nëse ekzistojnë kufij të respektimit të jetës private, në ç'raste duhet të vendosen ata (a mund të jenë kufijtë e njëjtë)?
- Cilat janë përfundimet që mund të nxirren nëse kjo çështje trajtohet?
  - Si çështje ligjore
  - Si çështje kulturore
  - Si çështje që lidhet me parandalimin e konfliktit etj.

Në fund mësuesi fton nxënësit të lexojnë pyetjet që bënë në fillim të orës së mësimi dhe u drejton atyre pyetjen:

A do të shkruanit të njëjtat pyetje pas kësaj ore mësimi? Përse?

A ka ndonjë nxënës që nuk i ka shkruar pyetjet menjëherë ose që ka kërkuar informacion shtesë...?

## **Vlerësimi**

Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të aftësisë së tyre:

- Për të dalluar, identifikuar mes të drejtave të shumta , të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (*njohja*),
- Për të lidhë standardin (të drejtat dhe “kufijtë” ) që lidhen me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit(*kontekstualizimi*),
- të tregojë rëndësinë e marrjes parasysh të kulturës të zakoneve, personalitetit etj, përpara se të marrin një vendim ose qëndrim që lidhet me respektimin e diversitetit etj. (zbatimi)

## Veprimtari 2

**Tema: Manipulimi i informacionit: Verifikoni dhe kushtojini rëndësi përpara se ta shpërndani**

### Qëllimi

Në këtë orë mësimore, nxënësit do të njihen me mundësinë e manipulimit të informacionit; me mundësinë e ndeshjes me informacionet e manipuluar dhe pasojat e mundshme që ato kanë në vendimmarrjet e tyre dhe të individëve në përgjithësi. Ata do të njihen me konceptet kryesore që lidhen me manipulimin e informacionit dhe format e shfaqjes së tyre në media.

Nxënësve u jepet mundësia të diskutojnë për pasojat e mundshme që ka manipulimi i informacionit për individin, grupin dhe shoqërinë dhe për këtë arsye, për rëndësinë që ka njohja dhe identifikimi i informacioneve manipuluese dhe i faktorëve që i krijojnë, i mbajnë gjallë dhe i përhapin dhe, për rrjedhojë, edhe për përgjegjësinë që duhet të ketë çdo individ që lufton për një shoqëri demokratike për ta identifikuar dhe ndaluar përhapjen e informacioneve manipuluese në të gjitha format e shfaqjes së tyre.

Suksesi i kësaj lufte varet jo vetëm nga njohja e dukurisë dhe e faktorëve që e krijojnë dhe e mbajnë gjallë, por edhe algoritmi, modeli e radha e veprimeve që duhet të ndjekë çdo individ në këtë drejtim.

Përveç kësaj, kjo veprimtari synon të sfidojë nxënësin si një krijues ose përhapës i mundshëm, me vetëdije ose jo, i informacioneve të manipuluar dhe i dialogut/reflektimeve që ai duhet të bëjë me veten përpara se kjo mundësi të kthehet në realitet.

### Rezultatet e pritshme të të mësuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë përmbajtjen e konceptit manipulim i informacionit dhe i formave të shprehjes së tij;
- të përmendë disa nga faktorët që krijojnë ose mbajnë gjallë format e çrregullimit të informacionit, kushtet që krijojnë terrenin e përshtatshëm për këta faktorë dhe pasojat e tyre për individin, grupin dhe shoqërinë;
- të identifikojë disa nga hapat që ai duhet të ndërmarrë kur ndeshet me një informacion, si hapi i parë drejt krijimit të një algoritmi (modeli) të qëndrueshëm për t'u zbatuar në rastet kur përballlet me informacione të reja (ose edhe të vjetra, të para në kohë dhe hapësirë tjetër).

## Zhvillimi i veprimtarisë

### Hapi i parë 6-7 minuta

Mësuesi u kërkon nxënësve të kujtojnë raste kur janë ndeshur me informacione që më vonë kanë dalë të gabuara si dhe rastet kur ata kanë marrë vendime mbi bazën e këtyre informacioneve. Ai u kërkon atyre të thonë disa nga llojet e pasojave të këtyre vendimeve për ta (për veten, familjen, grupin ku bëjnë pjesë etj.) Mësuesi shënon në tabelë ose në dërrasën e zezë përgjigjet e nxënësve për pasojat e vendimeve.

Në vijim mësuesi kërkon prej nxënësve të përmendin disa nga burimet e këtyre informacioneve të gabuara për shembull nga lajmet, platformat sociale që përdorin etj.) dhe sa shpesh marrin vendime mbi bazën e informacioneve që marrin prej tyre. Mësuesi u kërkon nxënësve të përmendin edhe burime të tjera nga kanë marrë informacionet e gabuara në lagje, shkollë etj.

### Hapi i dytë 15 minuta

Mësuesi u paraqet nxënësve tabelën e mëposhtme dhe u shpjegon atyre përmbajtje e koncepte që përshkruhen aty.



Në vijim mësuesi i fton nxënësit të mendojnë për çështjet që lidhen me secilin prej koncepteve:

1. Keqinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Përse mund të ndodhin keqinformimet?
- Cilat janë disa nga pasojat e keqinformimit

2. Dezinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Cilat mund të jenë disa nga shkaqet që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e dezinformimit?

3. Informim keqdashës

- Si shprehen informacionet keqdashëse?
- Cilat janë disa nga shkaqet e mundshme që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e informimit keqdashës?

Mësuesi shënon në tabelë pasojat e mundshme për secilin rast.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjen e mëposhtme dhe, për disa minuta, nxit diskutimin e klasës rreth saj?

- Çfarë duhet të bëjmë për të mos qenë viktima të manipulimit të informacionit?

**Hapi i tretë 15-17 minuta**

Mësuesi ndan klasën në grupe. Secili grup i jep detyrën të lexojnë një prej lajmeve në tabelën e mëposhtme.

Më tej ai kërkon prej tyre të verifikojnë lajmin duke u përgjigjur pyetjeve që ndodhen në tabelën e verifikimit të

## informacionit

Pyetje për verifikimin e informacionit	
1	Kush e ka krijuar mesazhin?
	A është ky burim i besueshëm?
2	Si përpiqet mesazhi ta mbërthejë vëmendjen time?
	A përdor germa shtypit?
	A përdor imazhe të forta?
3	Përse mendoni se është krijuar ky mesazh?
	Çfarë lloj veprimi mendoni se autori i mesazhit kërkon që ju të bëni pasi ta lexoni atë?
4	Kur u publikua mesazhi?
	A e ka datën?
	A ka datë të gabuar?
	A ka datë të vjetër?
5	Si u ndjetë nga ky mesazh?
	A mendoni se edhe të tjerët mund të kenë të njëjtat ndjesi si ju?

The image shows four social media posts, all containing the same text about a health tip for COVID-19. The posts are from TV Apollon, fakt.al, infirmieria shqiptare, and Eduart Ndocij. The text in each post is as follows:

**TV Apollon** (22 mins):  
 Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
 \*Receta është e thjeshtë\*  
 1. "Limon"  
 2. "Bikarbonat"  
 Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
 \*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**fakt.al** (1 hr):  
 Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
 \*Receta është e thjeshtë\*  
 1. "Limon"  
 2. "Bikarbonat"  
 Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
 \*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**infirmieria shqiptare** (2 hrs):  
 Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
 \*Receta është e thjeshtë\*  
 1. "Limon"  
 2. "Bikarbonat"  
 Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
 \*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**Eduart Ndocij** is with Eduart Ndocij and 9 others. (1 hr):  
 NE ISRAEL BKA VDEKJE NGA C-19!  
 Një super lajm ... Kështu mbërriti dhe kështu po dërgoj meqesi , nga një mik nga Ambasada Amerikane ne Tiranë.  
 Theshtë arritur kurimi për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
 \* Receta është e thjeshtë \*  
 1. "Limon"  
 2. "Bikarbonat"  
 Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi që kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse Populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin.  
 E ndaj me të gjithë familjen dhe miqtë e mi, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin. Unë e le atë në kriteret tuaja  
 \* Ju lutem kalojeni këtë menjëherë \*

Në fund grupet ndajnë përfundimet e tyre.

## Reflektim 5 minuta

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë për:

1. Përgjegjësinë e çdo individi për të përcjellë gjithmonë informacione të vërteta.
2. Përgjegjësinë e çdo individi që të aftësohet përmes shkollës që të dallojë gjithmonë çrregullimet e informacionit.
3. Përgjegjësinë e çdo individi që të përdorë hapat e verifikimit të informacionit sa herë që ndeshet me të.

Vlerësimi i nxënësit bëhet duke u bazuar në shkallën e përmbushjes së rezultateve të pritshme të të mësuarit

### *Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur*

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- Mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- I shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

### *Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur*

<b>Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur</b>				
<b>Gjithsej 70 pikë</b>				
<b>Përshkruesit</b>	<i>Niveli 1 - Dobët</i>	<i>Niveli 2 – Mjaftueshëm</i>	<i>Niveli 3 – Mirë</i>	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i>
<b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësit</b>	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësit (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësi, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e</i>	<i>4 pikë</i> <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodat dhe teknikat</i>	<i>5 pikë</i> <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka</i>

	<p><i>ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i></p>	<p><i>rezultateve të të nxënit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i></p>	<p><i>mësimore janë në një koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënit dhe me stilet e të nxënit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i></p>	<p><i>planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i></p>
<p><b>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore</b></p>	<p>0 – 1 pikë</p> <p><i>Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p>2 – 3 pikë</p> <p><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodrat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p>4 pikë</p> <p><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodrat e planifikuara fokusohen më së</i></p>	<p>5 pikë</p> <p><i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që</i></p>



			<p><i>shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>
<b>Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)</b>				
<p><b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</p>
<p><b>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> Mësuesi organizon orën e mësimit në</p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> Mësuesi organizon orën e mësimit në</p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> Mësuesi organizon orën e mësimit duke u</p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që</p>

<p><b>duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes</b></p>	<p><i>mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimet.</i></p>	<p><i>mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i></p>	<p><i>kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i></p>	<p><i>të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i></p>
---	--	---	---	--

### Metodat mësimore (21 pikë)

<p><b>Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të të nxënësve</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i nxit stilet e të nxënësve. Ora e mësimet është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i nxit stilet e të nxënësve të tij por ora e mësimet është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i nxit stilet e të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimet nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që nxit shumë mirë stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësve duke i dhënë mundësi nxënësve të përmirësojnë</i></p>
--	--	---	---	---

		<i>tyre të të nxënit.</i>	<i>jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>arritjet e tij.</i>
<b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin)</b>	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimit, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimit, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
<b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe</b>	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet</i>

<p><b>nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit</b></p>	<p><i>llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i></p>	<p><i>nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i></p>	<p><i>pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i></p>	<p><i>dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i></p>
---	---	--	---	--

**Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)**

<p><b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij</b></p>	<p>0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimt.</i></p>	<p>2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e</i></p>	<p>4 - 5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimt duke identifikuar</i></p>	<p>6 - 7 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe</i></p>
--	---	--	---	--

		<i>mësimi.</i>	<i>nevojat për përmirësim të tij.</i>	<i>lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
<b>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>
<b>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>

**Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)**

<p><b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore</b></p>	<p>0 – 1 pikë</p> <p><i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i></p>	<p>2 pikë</p> <p><i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i></p>	<p>3 pikë</p> <p><i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësve në përdorimin e tyre.</i></p>	<p>4 pikë</p> <p><i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënësve në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijuet.</i></p>
<p><b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve</b></p>	<p>0 – 1 pikë</p> <p><i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore,</i></p>	<p>2 pikë</p> <p><i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i></p>	<p>3 pikë</p> <p><i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësve nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i></p>	<p>4 pikë</p> <p><i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësve në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i></p>

